



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 3. 2. 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Mbledhja u monitorua nga: OSBE-ja, KDI-ja dhe Presidenca.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, zyrtar i lartë ligjor.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15. dhe 20. 01. 2009,
- 2 Miratimi i rekomandimeve:
 - a) Për Mistrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me petitionin e të diplomuarve në universitetet private,
 - b) Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me petitionin e oficerëve të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës, .
- 3 Të ndryshme.

Kryetari i propozoi Komisionit që rendit të ditës të kësaj mbledhjeje t'i shtohen dy pika:

1. **Propozimi për miratimin e Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008,**
2. **Shqyrtimi i Planit të punës dhe i strategjisë legjislative për vitin 2009**

Rendi i ditës u miratua me plotësim.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 15. dhe 20. 01. 2009

Kryetari - konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 15. dhe 20. 01.2009.

2 Miratimi i rekomandimeve:

a) Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me të diplomuarit në universitetet private

Ismet Beqiri -Para anëtarëve të Komisionit e shtroj çështjen e mosnjohjes së diplomave. U theksua se përfaqësuesit ndihen të diskriminuar për shkak se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nuk ua njeh zyrtarisht diplomat. Universiteti i Prishtinës nuk i njeh këto diploma si valide, në mënyrë që poseduesit e tyre të kenë të drejtë të marrin pjesë në konkurs për regjistrim në studimet master, në kuadër të këtij universiteti. Në këtë mënyrë të diplomuarve në universitetet private u mohohet e drejta për vazhdimin e studimeve master në Universitetin Publik. Ky asociacion shpreh mendimin se me këto veprime të diplomuarve në universitetet private u mohohen të drejtat themelore njerëzore të fushës së arsimit.

Prof. dr. Nerxhivane Dauti – Shqyrtimin e peticioneve e vlerësoi lart dhe me profesionalizëm. Lidhur me rekomandimet kërkoi të njoftohet opinioni për këtë çështje. Komisioni për punën e bërë ka lëvdatur. Studentët e fakultetit në të cilin ligjëroj shpesh më pyesin lidhur me statusin e diplomave etj.

Komisioni e shqyrtoi peticionin e Asociacionit të të Diplomuarve në universitetet private dhe pas një debati e nxori këtë

R e k o m a n d i m

- 1 *Komisioni i mbështet kërkesat e studentëve të diplomuar në universitetet private.*
- 2 *Nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë kërkohet që vendimin me shkrim për njohjen e diplomave të të diplomuarve në universitete private t'ua përcjellë Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Asociacionit të të Diplomuarve në Universitetet Private dhe Universitetit Publik të Prishtinës.*
- 3 *Komisioni i rekomandon Ministrisë që kandidatëve të diplomuar në universitetet private t'u lejohet regjistrimi në studime postdiplomike në Universitetin Publik.*

Komisioni vendosi që rekomandimet t'u adresohen institucioneve shtetërore: Ministrisë, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, kryeministrit, Asociacionit të të Diplomuarve në Universitetet Private dhe mediave.

b) Për Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me peticionin e oficerëve të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës

Ismet Beqiri, kryetar - Ceku se qëllimi i këtij takimi me përfaqësues të peticionit të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme ishte të gjendej një zgjidhje për këtë çështje, sepse ky ishte shqetësim edhe për Ministrinë, edhe për Kuvendin, meqë numri i nënshkruesve është i madh. Tha se kryeministri ka marrë vendim në gusht të 2008-s që oficerët e Sigurimit Policor të shndërrohen në policë.

Ibrahim Makolli – Tha se vendimi i Qeverisë së Kosovës, që i trajton ata si zyrtarë të policisë e ka ndryshuar statusin e tyre. Në peticion janë ngritur disa çështje, siç janë: mosnjohja e përvojës, e gradave, e pagave dhe e trajnimeve. Edhe pse e kam thënë më parë se ky divizion ishte pjesëtar i Shërbimit Policor, tani është viktimë e ndërtimit të këtyre mekanizmave. Si do të veprohet nëse disa nuk merren në Shërbimi Policor. Lidhur me rekomandimet kontribuuan në diskutimet e tyre: Naim Rrustemi, Sanije Aljaj, Hajredin Hysen, Drita Maliqi dhe Vezira Emrus.

Në mbledhje u zhvillua një debat i gjerë përkitazi me këtë problematikë dhe u vendos që Ministrisë së Punëve të Brendshme t'i adresohet ky

R e k o m a n d i m

1. Kërkohej nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës zbatimi i vendimit të Qeverisë nr. 04/30, të datës 19. 08. 2008, përkatësisht zbatimi i vendimit të kryeministrit të Kosovës, me të cilin ndryshohet statusi i oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës;
2. Komisioni i mbështetë kërkesat e nënshkrueseve të peticionit dhe i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme që rregullativa normative të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për policinë;
3. Komisioni i sugjeron Ministrisë së Punëve të Brendshme që këtyre pjesëtarëve të policisë t'u njihen: përvoja në punë, gradat, pagat dhe trajnimet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Komisioni vendosi që rekomandimet t'u adresohen institucioneve shtetërore: Ministrisë, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, kryeministrit, oficerëve të Divizionit të Sigurimit Policor të Kosovës

1. Propozimi për miratimin e Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008

Komisioni në parim e miratoi Planin e punës për vitin 2008 dhe kërkoi që anëtarët ta shqyrtojnë projektraportin dhe ta miratojnë në mbledhjen e ardhshme.

2. Shqyrtimi i Planit të punës dhe i strategjisë legjislative për vitin 2009

Kryetari - Shtoi: Në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03-P-070-P, të datës 27. 1. 2009, me të cilin kërkohet nga komisionet parlamentare që mbi bazën e strategjisë legjislative të Qeverisë, për vitin 2009 t'i hartojnë planet periodike të punës, programin e punës dhe u pajtua të miratohen në mbledhjen e radhës.

Ibrahim Makolli – Duke folur për raportin e BE-së, tha se në të flitet për të gjeturat, se gjoja ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës nuk u janë nënshtruar standardeve evropiane, as nuk janë harmonizuar me *Acquis communautaire*. Shkurtime për rëndësinë që e ka në parlamentet evropiane Komisioni për të Drejtat e Njeriut. Kërkoi që ai të jetë funksional për të gjitha projektligjet, si dhe të japë mendime për rregullimin e të drejtave dhe të detyrimeve. **Shprehu shqetësimin e zvarritjes së Projektligjit që e rregullon statusin e familjeve të personave të pagjetur.** Kërkoi që kjo çështje të ngrihet te kryetari, si edhe të shtrohet si çështje e Kuvendit.

Konstatim i përgjithshëm ishte që komisioni të kërkojë takim me kryetarin e Kuvendit të Republikës dhe njoftoi për të gjeturat e raportit të BE-së, lidhur me nevojën që në Rregulloren e punës të Kuvendit Komisioni për Drejtat e Njeriut ta ketë statusin e merituar si të homologut në BE.

Kryetari i falënderoi pjesëmarrësit për kontributin që e dhanë.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri